

VENDIM
Nr. 205, datë 27.6.2023

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLE 24 DOOEL SHKUP – DEGA NË SHQIPËRI”, DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 64, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1433/12 prot., datë 23.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi përfundimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Sole 24 Dooel Shkup – Dega në Shqipëri’, degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe njohjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit dhe tregtimit energjisë elektrike, dhënë nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për subjektin ‘Sole 24 Import-Eksport Dooel Shkup’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 29.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup – Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2023 dhe 31.5.2023), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe, në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 8.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1432/2 prot., datë 30.5.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1433/4 prot., datë 5.6.2023, shoqëria paraqiti kërkesë dhe dokumentacion për njohjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke argumentuar se në mungesë të informacionit mbi mundësinë e njohjes së licencës, sipas “Rregullores për licencimin”, ka dërguar fillimisht në ERE kërkesën përkatëse për marrjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1433/6 prot., datë 15.6.2023, ERE iu drejtua shoqërisë me kërkesën për saktësim të objektit të saj, në rast se kërkon nga ERE procedimin me njohjen e licencës, në mënyrë që të vijohet sipas përcaktimeve ligjore me procedurën e nisur për licencim.

- Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1433/9 prot., datë 21.6.2023, shoqëria ka saktësuar se kërkon anulimin e procedurës së nisur për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe vijimin e procedurës përkatëse për njohjen e licencës.

- Për sa parashikohet në nenin 64, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në rrethanat kur ERE nuk ka marrë ende një vendim përfundimtar mbi aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe shoqëria ka shprehur kërkesën e saj për t’u tërhequr nga kjo kërkesë dhe për të vijuar me procedurën e njohjes së licencës, vlerësohet përfundimi i procedurës së nisur për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup – Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sole 24 Dooel Shkup – Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti